



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.2884/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Adnan Konushevci, në çështjen juridike kontestuese të paditësit - propozuesit për masë të sigurisë Mejd Bektashi nga Prishtina, Rruga "Anton Çeta", Nr. 14, të cilin sipas autorizimeve e përfaqësojnë Fatlum Podvorica, Hamdi Podvorica dhe Arsim Billalli, që të gjithë avokat nga Prishtina, kundër të paditurës - kundërshtares së sigurimit OJQ "ADMOVERE" me seli në Prishtinë, Lagjja Ulpiana, C15, Hyrja 10, Nr. 6, me themelues Shkëlzen Gashi nga Prishtina, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Rina Kika, avokate nga Prishtina, Rruga "Miss Edith Durham", B1, Hyrja 1, Nr.11, me objekt kontesti, shpifje dhe fyerje, duke vendosur për propozimin për caktimin e masës së sigurimit, në seancën e mbajtur me datë 24.04.2019, në prani të ndërgjyqësve dhe përfaqësuesve të tyre, dhe duke vepruar kjo gjykatë sipas aktvendimit Ac.nr.5022/18 i datës 28.02.2019, të Gjykatës së Apelit, me datë 03.05.2019, mori këtë:

AKTVENDIM

REFUZOHET si i pabazuar, propozimi i paditësit - propozuesit të sigurimit Mejd Bektashi nga Prishtina, për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit dhe t'i ndalohet të paditurës - kundërshtares të sigurimit OJQ "ADMOVERE" me seli në Prishtinë, me themelues Shkëlzen Gashi nga Prishtina, qarkullimi i mëtejme, i studimit me emërtim "Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-student", të njëjtin ta tërheqë nga publikimi në mediat e shkruar, elektronike, web-faqe të internetit, në rrejte sociale, dhe t'i ndalohet kundërshtares së sigurimit përsëritja e veprimeve të tilla në të ardhmen, në raport me personalitetin e propozuesit të sigurimit, deri në përfundimin e këtij kontesti me vendim të formës së prerë, nën kërcenim të pasojave ligjore.

Arsyetim

Paditësi - propozuesi i sigurimit, nëpërmes përfaqësuesve të tij, në këtë gjykatë ka ushtruar padi me datë 01.10.2018, se bashku me propozim për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit dhe t'i ndalohet të paditurës - kundërshtares të sigurimit, qarkullimi i mëtejme, i studimit me emërtim "Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf - student", të njëjtin ta tërheqë nga publikimi në

mediat e shkruar, elektronike, web-faqe të internetit, në rrejte sociale, dhe t'i ndalohe kundërshtares së sigurimit përsëritja e veprimeve të tilla në të ardhmen, në raport me personalitetin e propozuesit të sigurimit, deri në përfundimin e këtij kontesti me vendim të formës së prerë, nën kërcenim të pasojave ligjore. Propozuesi i sigurimit shton se pa caktimin e kësaj mase të sigurisë propozuesit do të shkaktohet edhe mëtej dëm i pa riparueshëm sepse pretendimet e kundërshtares së sigurimit se pjesën e raportit të studimit lëndor e ka errësuar apo e ka bërë "tebdil", janë të pa bazuara ngase ajo pjesë e raportit vetëm është mbuluar me një letër të zezë mbi pjesën e shkrimit ku bëhet fjalë për propozuesin dhe e njëjta sipas propozuesit mund të hiqet lehtë dhe kjo mënyrë e errësimit të raportit është bërë vetëm në kopjet e raportit që u janë dorëzuar gjykatës, por jo edhe ekzemplarët e dërguar nëpër biblioteka dhe nëpër institucione shtetërore që i kanë në pronësi lexuesit. Me propozim për gjykatën që të aprovohet në tërësi propozimi për caktimin e masës së sigurimit.

Kundërshtarja e sigurimit si në përgjigje në masë të sigurimit, në seancën e mbajtur dhe në fjalën përfundimtare nëpërmes përfaqësueses të saj, ka theksuar se raporti i publikuar me emërtim "Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-student", nuk ka pas për qëllim ta dëmtoi askënd por qëllimi i këtij studimi ka qenë radhitja e të gjitha rasteve të plagjiaturës të pjesëtarëve të stafit akademik të UP-së, për të cilët është raportuar në media për gjatë viteve, duke filluar nga viti 1985, e deri në rastin e fundit të publikuar në media i vitit 2016. Kundërshtarja e sigurimit, e njofton gjykatën në këtë procedurë të rigjykitimit pavarësisht që nuk kanë qenë të pajtimit me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.2884/18 i datës 08.11.2018, megjithatë i kanë ndërmarr masat dhe e kanë larguar nga publikimi studimin lëndor në pjesën që ka të bëjë me propozuesin, duke e bërë tebdil faqen me nr. 43 të raportit dhe duke ju dërguar email të gjitha mediave me përmbajtje që ta largojnë nga publikimi pjesën e raportit që ka të bëjë me propozuesin. Me propozim për gjykatën që propozimi për caktimin e masës së sigurisë të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata, në këtë procedurë të rigjykitimit sipas udhëzimeve që kanë rezultuar nga aktvendimi Ac.nr.5022/18 i datës 28.02.2019, i Gjykatës së Apelit, bëri shikimin, vlerësimin e shkresave të lëndës, dëgjimin e ndërgjyqësve në cilësinë e palëve në procedurë, dhe ka ardh në përfundim se propozimi i propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, në këtë rast është i pa bazuar për këto arsye:

Gjykata për të vendosur lidhur me propozimin e caktimit të masës siguroese ju referua Nenit 297 të LPK-së, i cili përcakton se masa e sigurimit mund të caktohet: a) "Në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij" dhe b) "në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit".

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, konstatoi se propozimi i propozuesit për caktimin e masës së sigurisë është i pabazuar, kjo për arsye se kundërshtarja e sigurimit me rastin e marrjes së aktvendimit nga kjo gjykatë C.nr/2884/2018 i datës 08.11.2018, ka ndërmarr veprime konform aktvendimit të lartcekur, duke e errësuar respektivisht duke bërë të palexueshëm pjesën e studimit që ndërlidhet me propozuesin e sigurimit. Kundërshtarja e sigurimit nëpërmes postës elektronike të datës 11.11.2018, edhe përkundër asaj që nuk kanë qenë të pajtimit me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr/2884/2018 i datës 08.11.2018, i'ka njoftuar mediat se do ta zbatojnë aktvendimin e gjykatës dhe ju ka kërkuar të gjitha mediave që e kanë publikuar këtë studim ta tërheqin në pjesën që ka të bëjë me propozuesin e sigurimit, poashtu kundërshtarja e sigurimit ju ka bërë thirrje të gjitha palëve që e posedojnë kopjen e këtij raporti ta tërheqin nga qarkullimi pjesën që ndërlidhet me propozuesin e sigurimit deri në një vendim përfundimtar të gjykatës. Këto veprime të ndërmarra nga kundërshtarja e sigurimit pas marrjes së aktvendimit të kësaj gjykate C.nr/2884/2018 i datës 08.11.2018, kanë ndikuar që gjykata në procedurën e rigjyimit të vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pretendimet e propozuesit të sigurimit se eksiton rreziku që kundërshtarja e sigurimit mund ti përsërisë veprimet e kësaj natyre duke e dëmtuar në mënyrë të pa riparshme propozuesin, janë vlerësuar nga gjykata si të paqëndrueshme dhe nuk kanë ndikuar në marrjen e këtij vendimi sepse përveç anës deklarative, propozuesi i sigurimit nuk e ka argumentuar me ndonjë provë shkresore që ekziston rreziku se kundërshtarja e sigurimit do ti përsërisë në të ardhmen veprimet për të cilat pretendon propozuesi.

Bazuar në arsyet lartcekurat, gjykata e refuzoi propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit pasi vlerësoi se në këtë fazë të procedurës nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 297 par.1 pikat a) dhe b) të LPK-së, për tu caktuar një masë e tillë ngase gjykata nuk ka gjet arsye se propozuesit mund t'i rrezikohen realizimi i të drejtave subjektive të tij ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Nga se u tha më lart e konform dispozitave ligjore të parapara në nenin 387, lidhur me nenin 142 par. 5 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
C.nr.2884/18 datë 03.05.2019

Këshillë Juridike: *Kundër këtij aktvendimi kundër propozuesi i masës së sigurimit, ka të drejtën e ankesës në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij Aktvendimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit.*

